



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.4

28 janar

2010

P Ë R M B A J T J A

Faqe

Vendim i KM nr.38, datë 20.1.2010	Për disa shtesa në vendimin nr.965, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e vlerës së dëmeve të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e tërmetit, rënë në qarkun e Dibrës, dhe të listave emërore, me vlerat përfituese”.....	53
Udhëzim i KM nr.1, datë 13.1.2010	Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokat bujqësore të ish-NB-ve dhe të zonës së zhvillimit me përparësi turizmin	59
Udhëzim i KM nr.2, datë 13.1.2010	Për mënyrën e verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, nga komisionet vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, kur këtë e kërkojnë individë a institucione ...	67

VENDIM
Nr.38, datë 20.1.2010

**PËR DISA SHTESA NË VENDIMIN NR.965, DATË 30.9.2009 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR MIRATIMIN E VLERËS SË DËMEVE TË SHKAKTUARA NË
OBJEKTE, PRONË PRIVATE, SI RRJEDHOJË E TËRMETIT, RËNË NË QARKUN E
DIBRËS, DHE TË LISTAVE EMËRORE, ME VLERAT PËRFITUESE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 13 të ligjit nr.10190, datë 26.11.2009 “Për buxhetin e vitit 2010”, dhe të shkronjës “dh” të pikës 2 të nenit 5 të ligjit nr.8756, datë 26.3.2001 “Për emergjencat civile”, me propozimin e Ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Në vendimin nr.965, datë 30.9.2009 të Këshillit të Ministrave, bëhen këto shtesa:
 - a) Në fund të pikës 1 shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Miratimin e vlerës shtesë të dëmeve të shkaktuara në objekte, pronë private, si rrjedhojë e rënies së tërmetit në qarkun e Dibrës, në shumën 16 202 636 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë, sipas tabelës, që i bashkëlidhet këtij vendimi, si rezultat i procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit.”
 - b) Në fund të pikës 2, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Miratimin e listave shtesë, që i bashkëlidhen këtij vendimi, me emrat e individëve dhe shumën përkatëse të kompensimit, si rezultat i procesit të vlerësimit dhe rivlerësimit.”
 - c) Në fund të pikës 3, shtohet paragrafi, me këtë përmbajtje:

“Fondi 16 202 636 (gjashtëmbëdhjetë milionë e dyqind e dy mijë e gjashtëqind e tridhjetë e gjashtë) lekë të përballohet nga fondi rezervë i buxhetit të shtetit.”
2. Kryerja e pagesave për personat përfitues bëhet nga këshilli i qarkut të Dibrës.
3. Ngarkohen Ministria e Financave, Ministria e Brendshme dhe këshilli i qarkut të Dibrës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
ENTI KOMBËTAR I BANESAVE

PËRMBLEDHËSE E VLERËSIMIT TË DËMEVE TË BANESAVE NË RRETHIN E DIBRËS NGA TËRMETI I DATËS 6.9.2009
FAZA 2

Nr.	Emër, atësi, mbiemër	Adresa	Objekti	Vlera e dëmit
1	Mersin Xhemal Cakoni	Burrel	Shtëpi banimi	58680
2	Veli Rustem Tusha	Burrel, Koms	Shtëpi banimi	79354
3	Maksim Ismail Sadiku	Burrel, Koms	Shtëpi banimi	95328
4	Agim Bajram Kola	Burrel, Koms	Shtëpi banimi	234153
5	Murat Isak Hoxha	Derjan, Barbullej	Shtëpi banimi	988654
6	Halil Shaqir Isufi	Derjan, Barbullej	Shtëpi banimi	73868
7	Isuf Idriz Uka	Derjan, Derjan	Shtëpi banimi	202328
8	Ahmet Jakup Hidri	Derjan, Derjan	Shtëpi banimi	118271
9	Njazi Ramis Vargu	Gjoricë, Cerenec	Shtëpi banimi	424220
10	Aqif Riza Lusha	Gjoricë, Gjoricë	Shtëpi banimi	51445
11	Muis Cami	Gjoricë, Gjoricë e sipërme	Shtëpi banimi	42784
12	Mustafa Xhemail Xheka	Gjoricë, Viçisht	Shtëpi banimi	99252
13	Skënder Nafue Xheka	Gjoricë, Viçisht	Shtëpi banimi	85904
14	Behar Skënder Xheka	Gjoricë, Viçisht	Shtëpi banimi	45834
15	Bujar Aqif Cami	Gjoricë, Viçisht	Shtëpi banimi	19828
16	Hatixhe Avdi Xibri	Gurrë, Gurrë e madhe	Shtëpi banimi	67757
17	Mehmet Sali Baku	Gurrë, Rrupa	Shtëpi banimi	33643
18	Lezan Hasan Mëzhika	Klos, Cërujë	Shtëpi banimi	7455
19	Barie Isuf Hasula	Klos, Cërujë	Shtëpi banimi	127743
20	Mark Klimo Ballku	Klos, Cërujë	Shtëpi banimi	40362

21	Sadik Liman Pazari	Lis, Lis	Shtëpi banimi	54295
22	Mukades Hasan Asllani	Maqellarë, Burim	Shtëpi banimi	1040989
23	Natasha Nexhbedin Tema	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	38550
24	Dilaver Musa Spahiu	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	26946
25	Rufije Xhelal Zeneli	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	59293
26	Halim Sabri Hoxha	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	29550
27	Femi Sejfulla Qosja	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	47928
28	Tufije Buxhet Pilafi	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	11003
29	Floresha Sefedin Tema	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	56833
30	Artan Tahir Isaku	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	12575
31	Karafil Hamit Zerba	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	4212
32	Selam Tosum Selmani	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	44934
33	Qamil Fetah Spahiu	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	46932
34	Nafije Daut Selmani	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	55322
35	Emrije Veli Spahiu	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	25596
36	Iilir Tofik Selmani	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	72797
37	Bujar Nimet Spahiu	Maqellarë, Dovalan	Shtëpi banimi	139804
38	Drita Elez Veliu	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	112377
39	Ridian Shemsi Spahiu	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	13174
40	Mevlan Haziz Datja	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	68164
41	Hajrie Nasut Valiu	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	19887
42	Melaim Hysen Tuma	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	76990
43	Sefedin Baftjar Shahini	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	94621
44	Kadife Nezir Çuku	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	73306
45	Hajredin Faik Qoku	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	44513
46	Nexhmije Ramadan Çuku	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	145072
47	Safet Ramazan Çoku	Maqellare, Erebarë	Shtëpi banimi	77674

48	Athina Ilija Datja	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	103174
49	Zenulla Shefqet Datja	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	97675
50	Arben Brahim Datja	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	21393
51	Daije Mirvet Datja	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	30376
52	Nexhmije Avni Datja	Maqellarë, Erebarë	Shtëpi banimi	85284
53	Gazmir Kapllan Elezi	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	412104
54	Urim Envulla Elezi	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	95005
55	Naxhije Sait Elezi	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	107612
56	Qazim Envulla Elezi	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	69363
57	Miftar Gani Elezi	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	106623
58	Naxhie Ferit Bici	Maqellarë, Gradec	Shtëpi banimi	51463
59	Skënder Ali Hamzai	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	16990
60	Ramadan Bajram Halili	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	157350
61	Sali Halil Halili	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	104307
62	Mirushe Hajrulla Spahiu	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	253080
63	Rufije Mersim Halili	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	103702
64	Qemal Mustafa Aga	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	30585
65	Mehmet Aqif Gjura	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	73538
66	Engjellushe Belul Aga	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	59493
67	Shirete Iqmet Osmani	Maqellarë, Grezhdan	Shtëpi banimi	96175
68	Kabinë elektrike	Maqellarë, Kovashicë	Kabinë elektrike	72099
69	Bashkim Esat Osmani	Maqellarë, Pocest	Shtëpi banimi	3300
70	Xhami, Rreth Kale	Muhurr, Rreth-Kale	Xhami	45971
71	Qendra shëndetësore	Muhur, Rreth-Kale	Qendër shëndetësore	31831
72	Naim Halil Koçi	Ostren, Lejçan	Shtëpi banimi	117830

73	Kongres Fatmir Mija	Ostren, Lejçan	Shtëpi banimi	403546
74	Gazmen Rifat Mata	Ostren, Lejçan	Shtëpi banimi	198954
75	Evzat Rifat Mata	Ostren, Lejçan	Shtëpi banimi	229774
76	Artan Haxhi Manaj	Ostren, Lladomerice	Shtëpi banimi	53483
77	Bahri Bajram Adilaj	Ostren, Lladomerice	Shtëpi banimi	27957
78	Naxhije Rushit Adilaj	Ostren, Lladomerice	Shtëpi banimi	37466
79	Xhevat Ismet Shazimani	Ostren, Lladomerice	Shtëpi banimi	27544
80	Kujtim Mahmut Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	16766
81	Razie Istref Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	22232
82	Mitat Lutfi Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	28041
83	Arianita Rakip Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	24587
84	Zyberi Veli Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	19175
85	Vigjilencë Besim Muça	Ostren, Orzhanov	Shtëpi banimi	46614
86	Burrhan Ramazan Sula	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	32010
87	Fitime Muharrem Sula	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	34410
88	Zeqir Halit Hysa	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	41343
89	Hekuran Avni Sula	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	54135
90	Demir Ramazan Sula	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	53193
91	Hiqmet Idriz Karabrahimi	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	96117
92	Fahri Ermulla Limani	Ostren, Ostren i vogël	Shtëpi banimi	76014
93	Isuf Liman Rama	Ostren, Radovesh	Shtëpi banimi	26896
94	Bojaxhi Adem Dauti	Ostren, Radovesh	Shtëpi banimi	57613
95	Ismet Shahin Ismaili	Ostren, Radovesh	Shtëpi banimi	23153
96	Lirije Hamit Karasani	Ostren, Radovesh	Shtëpi banimi	21020
97	Defrim Qerim Rama	Ostren, Radovesh	Shtëpi banimi	1199026
98	Idajet Bashkim Muça	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	26565
99	Lulzim Bajram Muça	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	15015
100	Ali Velim Kurti	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	20966
101	Kongres Shyqyri Kurti	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	26534
102	Shemsi Demir Duka	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	18594
103	Fehmi Muharrem Duka	Ostren, Ostren i madh	Shtëpi banimi	38580

104	Veli Sabri Llani	Shupenzë, Boçeve	Shtëpi banimi	82452
105	Shefqet Ferit Kaci	Shupenzë, Boçeve	Shtëpi banimi	422976
106	Ismail Bajram Merxha	Shupenzë, Homezh	Shtëpi banimi	247545
107	Halil Mustafa Kurti	Shupenzë, Shupenzë	Shtëpi banimi	196405
108	Banush Hajdar Murra	Shupenzë, Shupenzë	Shtëpi banimi	24503
109	Besnik Jahe Daci	Shupenzë, Shupenzë	Shtëpi banimi	200737
110	Osman Ibrahim Veshi	Shupenzë, Okshatine	Shtëpi banimi	126971
111	Hysni Ibrahim Kola	Zerqan, Sopot	Shtëpi banimi	65380
112	Sali Hajdar Dufi	Zerqan, Peladhi	Shtëpi banimi	1154499
113	Muharrem Sadik Plaku	Zerqan, Peladhi	Shtëpi banimi	393945
114	Aqif Male Sejdi	Zerqan, Valikardh	Shtëpi banimi	1188462
115	Florian Gani Fiku	Zerqan, Godvi	Shtëpi banimi	439412
116	Defrim Novruz Plaku	Zerqan, Peladhi	Shtëpi banimi	462232
117	Xhabir Hasan Pata	Zerqan, Peladhi	Shtëpi banimi	613172
	VLERA TOTALE			16352537

UDHËZIM
Nr.1, datë 13.1.2010

**PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT APO TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE
TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKAT BUJQËSORE TË ISH-NB-VE
DHE TË ZONËS SË ZHVILLIMIT ME PËRPARËSI TURIZMIN**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 7, pika 2, shkronja “b” e 16 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

I. Për verifikimin apo shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, gjatë kontrolleve të drejtpërdrejta, që ushtrohen me nismën e komisioneve vendore të verifikimit të titujve të pronësisë, të ndiqen procedurat e parashikuara në këtë udhëzim.

II. Komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë, me nismën e vet, ushtron kontrolle të drejtpërdrejta e të plota mbi veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës së të gjitha niveleve, në procesin e ndarjes së tokës bujqësore, për:

a) sipërfaqet e tokave të ish-ndërmarrjeve bujqësore;

b) sipërfaqet në zonat e zhvillimit me përparësi turizmin, të përcaktuara në ligjin nr.7665, datë 21.1.1993 “Për zhvillimin e zonave, që kanë përparësi turizmin”, të ndryshuar, dhe në aktet nënligjore, dalë në zbatim të tij.

III. Drejtori i komisionit vendor, në bazë të programit vjetor të miratuar për veprimtaritë e kontrollit dhe verifikimit, përgatit urdhrin e kontrollit, i cili miratohet nga prefekti i qarkut. Në urdhër përcaktohen:

a) objekti i kontrollit, territori i komunës, fshatit, sektorit të ish-NB-së apo zona e zhvillimit me përparësi turizmin për fshatin përkatës;

b) qëllimi i kontrollit dhe verifikimi i vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore nga ish-komisionet e tokës së të gjitha niveleve;

c) përbërja e grupit të kontrollit me anëtarë të KV-ve;

ç) afati i kryerjes së kontrollit;

d) afati i dorëzimit të raportit përfundimtar të kontrollit dhe të projektvendimeve, që do të paraqiten për miratim në komisionin vendor.

IV. Drejtori i komisionit vendor, për mbledhjen e dokumentacionit që do të kontrollohet, përgatit dhe bashkëndëshkruan me prefektin një kërkesë, e cila u drejtohet institucioneve të mëposhtme:

1. Zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, ku i kërkohet:

a) lista e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi që disponon, sipas modelit të paraqitur në lidhjen “A”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, për sipërfaqen, objekt i kontrollit;

b) fotokopja e listës së akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe e hartave treguese të regjistrimit që disponon, për të cilat do të kryhet verifikimi apo shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore;

c) gjendja juridike e pronësisë së ngastrave, sipas listës, të përcaktuar në shkronjën “a” të pikës 1, për të cilat do të kryhet verifikimi apo shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore, sipas modelit të paraqitur në lidhjen “A”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi;

ç) çdo dokumentacion tjetër në lidhje me to, kur komisioni vendor e vlerëson të nevojshëm për shqyrtimin administrativ.

Me marrjen e kërkesës së komisionit vendor, zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme, për sipërfaqen, objekt i kontrollit, nuk do të regjistrojë asnjë akt dhe nuk do të japë asnjë shërbim për aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, që, në ndonjë rast, nuk janë përfshirë në listën sipas lidhjes “A”, pa e përcjellë më parë në komisionin vendor për verifikim.

2. Seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut, ku i kërkohen:

a) të dhëna për sipërfaqen e tokës bujqësore, e vënë në dispozicion për t'u ndarë sipas fshatrave, më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore;

b) të dhëna për normën e tokës bujqësore në m², për frymë sipas fshatrave, më 1.8.1991 për ish-kooperativat bujqësore apo më 1.10.1992 për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke përcaktuar treguesit e domosdoshëm, në përputhje me vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave “Për kriteret e ndarjes së tokës bujqësore”, të ndryshuar;

c) kopja e njësuar me origjinalin e dokumentacionit (vendimet) për veprimtarinë e veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës së fshatrave, të komunës, të këshillit të rrethit e të këshillit të qarkut, në procesin e ndarjes së tokës, për të gjithë periudhën e funksionimit, që disponon;

ç) hartat (në shkallën 1:5000) dhe regjistrat kadastralë (librat e ngastrave), të datës 1.8.1991, sipas fshatrave, për ish-kooperativat bujqësore dhe për ish-ndërmarrjet bujqësore, territoret e të cilave janë objekt i këtij kontrolli;

d) lista e pronarëve themelues për fshatrat e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe dosja e dokumentacionit, në bazë të së cilës është provuar qenia “themelues”.

Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut, me marrjen e kërkesës së komisionit vendor për sipërfaqen, objekt kontrolli, nuk do të dërgojë asnjë akt të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për regjistrim në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, por do ta dërgojë atë, paraprakisht, për verifikim në këtë komision.

3. Kryetarit të komunës/bashkisë, ku i kërkohen:

a) të dhëna për sipërfaqen e tokës bujqësore të vënë në dispozicion për t'u ndarë, sipas fshatrave, më 1.8.1991 për ish-kooperativat bujqësore apo më 1.10.1992 për ish-ndërmarrjet bujqësore (hartat në shkallën 1:5000 dhe librat e ngastrave);

b) të dhëna për numrin e frymëve sipas fshatrave, më 1.8.1991 për ish-kooperativat bujqësore apo më 1.10.1992 për ish-ndërmarrjet bujqësore (nga regjistrat e zyrës së gjendjes civile);

c) lista e anëtarëve të ish-kooperativës bujqësore, kur ish-tokat e saj shtrihen në zonën e zhvillimit me përparësi turizmin, si dhe lista e punonjësve të ish-ndërmarrjes bujqësore (sipas regjistrave që disponon arkivi i komunës);

ç) të dhëna për normën e tokës bujqësore në m² për frymë, sipas fshatrave, më 1.8.1991 për ish-kooperativat bujqësore apo më 1.10.1992 për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke përcaktuar treguesit e domosdoshëm, në përputhje me vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave (sipas formularëve të udhëzuesit teknik të Ministrit të Bujqësisë, datë 17.8.1991);

d) kopja e njësuar me origjinalin e dokumentacionit (vendimet) për veprimtarinë e veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës të fshatrave dhe të komunës, në procesin e ndarjes së tokës, për të gjithë periudhën e funksionimit që disponon;

dh) lista e pronarëve themelues për fshatrat e ish-ndërmarrjeve bujqësore dhe dosja e dokumentacionit, në bazë të së cilës është provuar qenia “themelues”;

e) çdo informacion tjetër që do të gjykohet nga komisioni vendor i nevojshëm për kryerjen e plotë të kontrollit.

4. Seksionit të urbanistikës, në këshillin e qarkut, ku i kërkohen:

a) harta e zonës së zhvillimit me përparësi turizmin, e përcaktuar sipas ligjit nr.7665, datë 21.1.1993, të ndryshuar, dhe akteve nënligjore, dalë në zbatim të tij;

b) harta e vijës kufizuese të ndërtimit për secilin fshat, objekt i kontrollit.

5. Zyrës Rajonale të Arkivit të Shtetit, ku i kërkohet dokumentacioni që disponon për ndarjen e tokës bujqësore, për sipërfaqen, objekt i kontrollit.

6. Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ku i kërkohet të konfirmojë, për përfituesit e tokës bujqësore, qenien apo jo, më 1.8.1991, anëtarë të ish-kooperativës bujqësore, apo më 1.10.1992, punonjës të ish-ndërmarrjes bujqësore, sipas akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për të cilët do të kryhet shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore.

V.Komisioni vendor, pas mbledhjes së dokumentacionit të sipërpërmendur, harton listën e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të administruara, për këtë sipërfaqe (territor), si dhe fillon procedurën e shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të secilit akt të marrjes së tokës

bujqësore në pronësi, sipas kritereve të përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar.

VI. Kur, pas verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, rezulton se:

1. aktet janë krijuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 dhe 4 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, atëherë KV-ja, me vendim deklaror vlefshmërië ligjore të krijimit të këtyre akteve dhe përgatit, për këtë, dokumentin e ri për rikonfirmim, sipas modelit të paraqitur në lidhjen “B”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Ky dokument përgatitet në tri kopje, nga të cilat:

a) një kopje e lidhur me vulë lidhëse me fotokopjen e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi i dërgohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për t’iu bashkëlidhur aktit origjinal të marrjes së tokës bujqësore në pronësi;

b) një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore;

c) një kopje, së bashku me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe dokumentacionin e krijuar, ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor.

Komisioni vendor mban një regjistër të veçantë, për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të rikonfirmuara, kopertina e të cilit përgatitet sipas modelit të paraqitur në lidhjen “C”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, ndërsa fletët kanë përmbajtjen sipas modelit të paraqitur në lidhjen “D”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

2. Aktet janë krijuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, atëherë KV-ja vendos për pavlefshmërië ligjore të titullit të pronësisë dhe i drejtohet gjykatës me kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë së aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, shfuqizimin e tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit, në përputhje me nenet 9 e 10 të ligjit të sipërpërmendur.

3. Aktet, pjesërisht, për një pjesë sipërfaqeje, janë krijuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, ndërsa pjesërisht në kundërshtim me këto kritere, atëherë KV-ja vendos, si më poshtë vijon:

a) Kur cenohet interesi shtetëror, për pavlefshmërië ligjore të pjeshme të titullit të pronësisë dhe i drejtohet gjykatës me kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë së pjeshme të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, shfuqizimin e pjeshëm të tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit, në përputhje me nenet 9 e 10 të ligjit të sipërpërmendur.

b) Kur cenohet interesi i familjes bujqësore, në favor të së cilës është lëshuar akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi, plotësimin e tij. Vendimi titullohet “Vendim për plotësimin e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi” dhe përgatitet në tri kopje origjinale, nga të cilat:

- një kopje e lidhur me vulë lidhëse me fotokopjen e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi i dërgohet zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për t’iu bashkëlidhur aktit origjinal të marrjes së tokës bujqësore në pronësi;

- një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore;

- një kopje, së bashku me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe dokumentacionin e krijuar, ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor.

Komisioni vendor është i detyruar që për të gjitha aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për të cilat vendos plotësimin e tyre, të mbajë një regjistër të veçantë. Në kopertinën e këtij regjistri vihet titulli “Regjistër i vendimeve për plotësimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi”, ndërsa në faqet e këtij regjistri duhet të regjistrohen të dhënat e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, i cili po plotësohet, të dhënat e vendimit për plotësimin e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, si dhe dispozitivi i tij.

Në asnjë rast, plotësimi i mangësive apo parregullsive të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, nuk mund të synojë:

- ndryshimin e gjendjes juridike të pronësisë;

- shtimin e sipërfaqes së tokës bujqësore mbi sipërfaqen e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi;

- ndryshimin e vendndodhjes së ngastrave të përcaktuara në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi.

VII. Në rast se gjatë kontrollit të dokumentacionit për veprimtarinë dhe veprimet e kryera nga ish-komisionet e tokës, të të gjitha niveleve, në procesin e ndarjes së tokës bujqësore, për të gjithë periudhën e funksionimit konstatohen veprimet e përcaktuara në pikën 1 të nenit 15 të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, atëherë KV-ja ka përgjegjësi të bëjë kallëzim penal në organet e drejtësisë.

VIII. Në përfundim të procesit të verifikimit apo të shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore hartohet raporti përfundimtar i kontrollit, për sipërfaqen, objekt i kontrollit, një kopje e të cilit i dërgohet sekretariatit teknik për t'u paraqitur në Komisionin Qeveritar të Tokës, së bashku me vendimet përkatëse.

IX. Komisioni vendor ndjek të njëjtën procedurë kontrolli edhe në rastet e kontrollit të veprimtarisë e të veprimeve të kryera nga ish-komisionet e tokës të të gjitha niveleve, në procesin e ndarjes së tokës bujqësore, edhe për sipërfaqe të tjera të tokës bujqësore, që nuk plotësojnë kushtet e përcaktuara në pikën I të këtij udhëzimi, por duhet të kontrollohen si rezultat i informacioneve të ndryshme, të paraqitura nga institucionet shtetërore, veprimtaria e të cilëve lidhet me pronësinë mbi tokën bujqësore.

X. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Komisioni Qeveritar i Tokës për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi, për institucionet në varësi të tyre.

XI. Ngarkohen sekretariati teknik, pranë Komisionit Qeveritar të Tokës, dhe komisionet vendore të vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

LISTA E AMTB-VE TË FSHATIT _____, KOMUNA _____ RRETHI _____
TË ADMINISTRUARA NË ZVRPP DER MË DATË _____

Nr	Nr. AMTP	Data AMTP	Përfaqësuesi i familjes bujqësore	Ngastrat AMTP	Sip. m ²	Zëri Kadast	po/jo Transaks	Të ndryshme
1								
Sipërfaqja e përgjithshme								
2								
Sipërfaqja e përgjithshme								
3.								
Sipërfaqja e përgjithshme								
4								
Sipërfaqja e përgjithshme								
5								
Sipërfaqja e përgjithshme								
6								
Sipërfaqja e përgjithshme								

REGJISTRUESI

Faqja 1 nga 5

Firma vula



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTURA
KOMISIONI VENDOR I VERIFIKIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI
TOKËN BUJQËSORE

Nr. _____ regjistri

AKT
RIKONFIRMIMI

I TITULLIT TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

Bazuar në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore me vendimin nr. _____, datë _____, vendosi të rikonfirmojë aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. _____, datë _____, në emër të z. _____, lëshuar nga komisioni i tokës i fshatit _____, komuna _____, i cili përmban këto ngastra:

Nr.	Vendndodhja		Sipërfaqja	Zëri kadastral
	Emri i ngastrës	Nr.ngastrës 1:5000		
1.				

Ky dokument përgatitet në tri kopje:

1. Një kopje dërgohet në ZVRPP për t’iu bashkëlidhur aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.
2. Një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore.
3. Një kopje ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor, dhe regjistrohet në regjistrin e veçantë “Për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi të rikonfirmuara”

DREJTORI I KV

PREFEKTI

PREFEKTURA _____

KOMISIONI VENDOR I VERIFIKIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË

**REGJISTRI I VENDIMEVE PËR AKTET E MARRJES SË
TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI TË RIKONFIRMUARA**

Numri rendor	Numri vendimit	Data vendimit	Përfaqësuesi i familjes bujqësore	Numri AMTBP	Data AMTBP	Fshati	Komuna	Zona kadastrale	Data e përcjelljes në ZVRPP	Nënshkrimi i drejtorit të KV
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										

UDHËZIM
Nr.2, datë 13.1.2010

**PËR MËNYRËN E VERIFIKIMIT APO TË SHQYRTIMIT TË VLEFSHMËRISË LIGJORE
TË KRIJIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE, NGA
KOMISIONET VENDORE TË VERIFIKIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË, KUR KËTË E
KËRKOJNË INDIVIDË A INSTITUCIONE**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve e 7, pika 2, shkronja “a”, e 16, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Shtetit për Reformat dhe Marrëdhëniet me Kuvendin, Këshilli i Ministrave

UDHËZON:

A. Komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë (KV) kryejnë verifikimin apo shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore, kur kërkesa paraqitet nga :

I. Zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme.

1. Zyra vendore e regjistrimit të pasurive të paluajtshme dërgon në KV kërkesën për verifikimin apo shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të aktit të marrjes së tokës në pronësi, bashkë me relacionin përkatës, kur, në bazë të shkronjës “ç”, të pikës 2/1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, konstaton se regjistrimi në origjinë i tokës bujqësore ka mangësi apo është kryer në kundërshtim me ligjin, sepse:

a) në aktin e marrjes së tokës në pronësi mungojnë një apo më shumë elementeve të formës a përmbajtjes, të përcaktuara në pikën 1, të këtij udhëzimi.

Në këto raste KV-ja vendos:

i) Mosshqyrtimin e kërkesës, kur akti i marrjes së tokës në pronësi (origjinali, dokumenti i njehsuar me origjinalin, publikata apo fotokopja e noterizuar) rezulton se nuk plotëson të paktën njërën nga kërkesat e përcaktuara në shkronjat “a”, “b” e “ç”, të pikës 1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave.

ii) Shqyrtimin e kërkesës, kur akti i marrjes së tokës në pronësi (origjinali, dokumenti i njehsuar me origjinalin, publikata apo fotokopja e noterizuar), rezulton se nuk plotëson të paktën njërën nga kërkesat e përcaktuara në shkronjat “c”, “d” e “dh”, të pikës 1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave.

b) akti i marrjes së tokës në pronësi nuk administrohet në zyrën e regjistrimit ose administrohet një kopje e panoterizuar, edhe pse regjistrimi rezulton i kryer. KV-të për kërkesat e paraqitura për këto raste vendosin mosshqyrtimin e tyre.

c) është kryer në bazë të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, me shënimin "Dublikatë". KV-ja në këto raste vendos shqyrtimin e kërkesave të paraqitura.

ç) sipërfaqja e të gjitha pasurive të dhëna me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, në total, del më e vogël se sipërfaqja e këtyre pasurive, të dala gjatë regjistrimit fillestar dhe të pasqyruara në kartelat e pasurisë. KV-ja vendos shqyrtimin e kërkesave të paraqitura për këto raste vetëm kur kërkuesi ka përcaktuar saktësisht çfarë kërkon të verifikojë apo shqyrtojë në aktin përkatës të marrjes së tokës në pronësi.

2. Kur KV-ja ka vendosur shqyrtimin e kërkesave të sipërpërmendura, mbledh dokumentacionin e nevojshëm, duke iu drejtuar institucioneve të mëposhtme:

a) kryetari të komunës/bashkisë përkatëse, të cilit i kërkohet:

i) sipërfaqja e tokës bujqësore, të vënë në dispozicion për t’u ndarë, sipas fshatrave, më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore;

ii) numri i frymëve , sipas fshatrave, më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore;

iii) norma e tokës bujqësore, në m², për frymë, sipas fshatrave, më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke specifikuar treguesit e domosdoshëm, të përcaktuar në vendimin nr.255, datë 2.8.1991 të Këshillit të Ministrave;

iv) konfirmimi nëse është lëshuar apo jo akti i marrjes së tokës në pronësi, në sipërfaqen e tokës bujqësore, sipas aktit që verifikohet apo shqyrtohet, për persona të tjerë;

v) çdo informacion tjetër, që gjykohet i nevojshëm për zgjidhjen e drejtë të kërkesës.

b) seksionit të administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut, të cilit i kërkohet:

i) konfirmimi i zërit kadastral, për ngastrën/ngastrat, sipas aktit të marrjes së tokës në pronësi, të paraqitur për verifikim apo shqyrtim;

ii) sipërfaqja e tokës bujqësore, për fshatin ku ndodhet sipërfaqja e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të paraqitur për verifikim apo shqyrtim, vënë në dispozicion për t'u ndarë më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore;

iii) norma e tokës bujqësore, në m², për frymë, për fshatin ku ndodhet sipërfaqja e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të paraqitur për verifikim apo shqyrtim, më 1.8.1991, për ish-kooperativat bujqësore, apo më 1.10.1992, për ish-ndërmarrjet bujqësore, duke specifikuar treguesit e domosdoshëm, të përcaktuar në vendimin nr.255, datë 2.8.1991, të Këshillit të Ministrave.

c) zyrës vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, së cilës i kërkohet konfirmimi i gjendjes juridike aktuale të pronësisë, për ngastrën/ngastrat, sipas aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për të cilin do të kryhet verifikimi apo shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore.

ç) Institutit të Sigurimeve Shoqërore, të cilit i kërkohet të konfirmojë nëse përfituesit e tokës bujqësore, sipas aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për të cilin do të kryhet verifikimi apo shqyrtimi i vlefshmërisë ligjore, kanë qenë ose jo më 1.8.1991 anëtarë të ish-kooperativës bujqësore apo më 1.10.1992 punonjës të ish-ndërmarrjeve bujqësore,.

II.Seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut.

1. Seksioni i administrimit dhe mbrojtjes së tokës, në këshillin e qarkut, dërgon në KV kërkesën për verifikim apo shqyrtim të vlefshmërisë ligjore të krijimit të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, së bashku me relacionin përkatës, në bazë të pikave 4 e 4/1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave, kur konstatojnë se akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi është kryer në kundërshtim me ligjin, për shkak se:

a) përfituesi nuk ka qenë subjekt i trajtimit me tokë bujqësore, sipas njërit nga aktet e mëposhtme, ligjore e nënligjore,: ligjit nr.7501, datë 19.7.1991, "Për tokën", të ndryshuar, ligjit nr.8053, datë 21.12.1995, "Për kalimin në pronësi pa shpërblim të tokës bujqësore", ligjit nr.8312, datë 26.3.1998, "Për tokat bujqësore të pandara", dhe vendimit nr.452, datë 17.10.1992, të Këshillit të Ministrave, "Për ristrukturimin e ndërmarrjeve shtetërore", të ndryshuar.

KV-ja, për këto raste, vendos shqyrtimin e kërkesave të paraqitura.

b) akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi nuk përmban të gjitha elementet e përcaktuara në pikën 1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave.

KV-ja për kërkesat e paraqitura në këto raste vendos:

i) mosshqyrtimin e kërkesës, kur akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi (origjinali, dokumenti i njësuar me origjinalin, publikata apo fotokopja e noterizuar) rezulton se nuk plotëson të paktën njërin nga kërkesat e përcaktuara në shkronjat "a", "b" e "ç", të pikës 1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave.

ii) shqyrtimin e kërkesës, kur akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi (origjinali, dokumenti i njësuar me origjinalin, publikata apo fotokopja e noterizuar), rezulton se nuk plotëson të paktën njërin nga kërkesat e përcaktuara në shkronjat "c", "d" e "dh", të pikës 1, të udhëzimit nr.2, datë 8.4.2009, të Këshillit të Ministrave.

c) planvendosja nuk është konfirmuar nga komuna/bashkia përkatëse. KV-ja, për kërkesat e paraqitura në këto raste, vendos, fillimisht, shqyrtimin e tyre dhe nëse rezulton se akti është i rregullt është e detyruar ta shoqërojë atë me planvendosje, sipërfaqja e së cilës të përputhet me atë të përcaktuar në akt. Planvendosja realizohet, paraprakisht, nga qytetari me një topograf të licencuar dhe pas verifikimit nga topografi i KV-së merr konfirmimin e komisionit vendor.

2. Kur KV-ja vendos shqyrtimin e kërkesave të sipërpërmendura, kërkon dokumentacionin e përcaktuar në shkronjat “a”, “b”, “c” e “ç”, të pikës 2, të kreut A, të këtij udhëzimi.

B. Komisioni vendor pas marrjes së kërkesës dhe të relacionit përkatës, nga zyrat vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme dhe seksionet e administrimit dhe mbrojtjes së tokës, është i detyruar të njoftojë personat, të drejtat dhe interesat e ligjshme të të cilëve mund të preken, si rezultat i veprimeve të ndërmarra gjatë procedimit administrativ, kur këta persona mund të identifikohen, dhe fillon procedurën për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.

C. Kur KV-ja pas verifikimit apo shqyrtimit të vlefshmërisë ligjore të krijimit të akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi konstaton se:

a) këto akte janë krijuar në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, deklaron, me vendim, vlefshmërinë ligjore të krijimit të tyre dhe përgatit dokumentin e ri për rikonfirmim, sipas modelit të paraqitur në lidhjen “B”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi. Ky dokument përgatitet në tri kopje, nga të cilat:

i) një kopje, e lidhur me vulë lidhëse me fotokopjen e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, dërgohet në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme, e cila i bashkëlidhet aktit origjinal të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.

ii) një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore.

iii) një kopje, së bashku me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe dokumentacionin e krijuar, ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor.

KV-ja mban një regjistër të veçantë për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi të rikonfirmuara, kopertina e të cilit përgatitet sipas modelit të paraqitur në lidhjen “C”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi, ndërsa fletët kanë përmbajtjen sipas modelit të paraqitur në lidhjen “D”, që i bashkëlidhet këtij udhëzimi.

b) këto akte janë krijuar në kundërshtim me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4, të ligjit nr. 9948, datë 7.7.2008, të ndryshuar, vendos pavlefshmërinë ligjore të titullit të pronësisë dhe i drejtohet gjykatës me kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë së aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, shfuqizimin e tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit, në përputhje me nenin 9 e 10, të ligjit të sipërpërmendur.

c) këto akte janë krijuar, pjesërisht, për një pjesë të sipërfaqes, në përputhje me kriteret e përcaktuara në nenet 2, 3 e 4, të ligjit nr.9948, datë 7.7.2008, ndërsa pjesërisht në kundërshtim me këto kritere, vendos, si më poshtë vijon:

i) Kur cenohet interesi shtetëror vendos pavlefshmërinë ligjore të pjesëshme të titullit të pronësisë dhe i drejtohet gjykatës me kërkesë për deklarimin e pavlefshmërisë së pjesëshme të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, shfuqizimin e pjesëshëm të tij dhe kthimin e pronës në pronësi të shtetit, në përputhje me nenet 9 e 10 të ligjit të sipërpërmendur.

ii) kur cenohet interesi i familjes bujqësore, në favor të së cilës është lëshuar akti i marrjes së tokës bujqësore në pronësi, vendos plotësimin e këtij akti. Vendimi titullohet “Vendim për plotësimin e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi” dhe përgatitet në tri kopje origjinale, nga të cilat:

- një kopje e lidhur me vulë lidhëse me fotokopjen e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, dërgohet në zyrën vendore të regjistrimit të pasurive të paluajtshme për t’iu bashkëlidhur aktit origjinal të marrjes së tokës bujqësore në pronësi;

- një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore;

- një kopje, së bashku me aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe dokumentacionin e krijuar, ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor.

KV-ja është e detyruar që për të gjitha aktet e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, për të cilat vendos plotësimin e tyre, të mbajë një regjistër të veçantë. Kopertina e këtij regjistri titullohet “Regjistër i vendimeve për plotësimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi”, ndërsa në faqet e brendshme të regjistrit regjistrohen të dhënat e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, që po plotësohet, të dhënat e vendimit për plotësimin e aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi dhe dispozitivi i tij.

Në asnjë rast, plotësimi i mangësive apo i parregullsive të aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi, nuk duhet të synojë:

- ndryshimin e gjendjes juridike të pronësisë;
- shtimin e sipërfaqes së tokës bujqësore mbi sipërfaqen e përcaktuar në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi;
- ndryshimin e vendndodhjes së ngastrave, të përcaktuara në aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi.

Ç. Për kërkesat e individëve për shfuqizimin e aktin e marrjes së tokës bujqësore në pronësi, të dikujt tjetër, me argumentimin se është dhënë në kundërshtim me ligjin, KV-ja vendos shqyrtimin e tyre.

D. Ngarkohen Ministri i Brendshëm, Ministri i Drejtësisë, Ministri i Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Komisioni Qeveritar i Tokës për ndjekjen e zbatimit të këtij udhëzimi nga institucionet e tyre të varësisë.

DH. Ngarkohen sekretariati teknik, pranë Komisionit Qeveritar të Tokës, dhe komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë për zbatimin e këtij udhëzimi.

Ky udhëzim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTURA
KOMISIONI VENDOR I VERIFIKIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË MBI
TOKËN BUJQËSORE

Nr. _____ regjistri

AKT
RIKONFIRMIMI

I TITULLIT TË PRONËSISË MBI TOKËN BUJQËSORE

Bazuar në ligjin nr.9948, datë 7.7.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, dhe akteve nënligjore në zbatim të tij, komisioni vendor i verifikimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore me vendimin nr. _____, datë _____, vendosi të rikonfirmojë aktin e marrjes së tokës në pronësi me nr. _____, datë _____, në emër të z. _____, lëshuar nga komisioni i tokës i fshatit _____, komuna _____, i cili përmban këto ngastra:

Nr.	Vendndodhja		Sipërfaqja	Zëri kadastral
	Emri i ngastrës	Nr. ngastrës 1:5000		
1.				

Ky dokument përgatitet në tri kopje:

1. Një kopje dërgohet në ZVRPP për t’iu bashkëlidhur aktit të marrjes së tokës bujqësore në pronësi.
2. Një kopje i jepet përfaqësuesit me prokurë të familjes bujqësore.
3. Një kopje ruhet në dosjen përkatëse të komisionit vendor, dhe regjistrohet në regjistrin e veçantë “Për regjistrimin e akteve të marrjes së tokës bujqësore në pronësi të rikonfirmuara”

DREJTORI I KV

PREFEKTI

PREFEKTURA _____

KOMISIONI VENDOR I VERIFIKIMIT TË TITUJVE TË PRONËSISË

**REGJISTRI I VENDIMEVE PËR AKTET E MARRJES SË
TOKËS BUJQËSORE NË PRONËSI TË RIKONFIRMUARA**

Numri rendor	Numri vendimit	Data vendimit	Përfaqësuesi i familjes bujqësore	Numri AMTBP	Data AMTBP	Fshati	Komuna	Zona kadastrale	Data e përcjelljes në ZVRPP	Nënshkrimi i drejtorit të KV
1										
2										
3										
4										
5										
6										
7										
8										
9										
10										
11										

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Zhan d'Ark”, prapa ish-ekspozitës "Shqipëria Sot", tel: 04 2258 472 (Kryeredaktori). Çmimi i abonimit në postë për Fletoret Zyrtare 2009 është 16 000 lekë. Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI I PROCEDURËS CIVILE	240 lekë
KODI PENAL	226 lekë
KODI I PROCEDURËS PENALE.....	330 lekë
KODI CIVIL	410 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I FAMILJES	270 lekë
KUSHTETUTA	95 lekë
KODI I PROCEDURËS ADMINISTRATIVE	90 lekë
PËRMBLEDHËSE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë

Hyri në shtyp më 28.1.2010
Doli nga shtypi më 28.1.2010

Tirazhi: 3300 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja ADEL PRINT
Tiranë, 2010

Çmimi 24 lekë